



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 13 shtator 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Gani Geci, Bajram Kosumi, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha Adem Hajdaraj dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Radmila Vujović – ishte në udhëtim zyrtar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Xhevat Sopi – RTK, Teuta Rexhepi – Bota Sot, Lumnije Murati – ZPRK, Lumnije Berisha – OSBE dhe Isuf Zejna – KDI.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 shtatorit 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë dhe i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile të luftës së UÇK-së dhe të familjeve të tyre,
4. Shqyrtimi i amendamenteve në Projektligjin për qasje në dokumente publike, të propozuara nga Komisioni Funkcional,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 shtatorit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 7 shtator 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë dhe i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile të luftës së UÇK-së dhe të familjeve të tyre

Kryetari - I njoftoi se Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile të luftës së UÇK-së dhe të familjeve të tyre do të shqyrtohet nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Propozoi që për këto projektligje të caktohen grupe pune dhe të mbahet një dëgjim publik për Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile të luftës së UÇK-së dhe të familjeve të tyre.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në grupin e punës për Projektligjin për të drejtat e ish-të burgosurve politikë të jenë Bajram Kosumi, Kolë Berisha dhe Ramadan Gashi.

Ramadan Gashi - U pajtua me propozimin e Ibrahim Makollit. Kërkoi që në shqyrtimin e mëtejshëm në grupet e punës të ftohet Hydajet Hyseni.

Kryetari - Theksoi se në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të shikohet mënyra si do të punohet në dy komisione.

Meqë nuk kishte vërejtje kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

I. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë në këtë përbërje:

*Bajram Kosumi- kryesues,
Kolë Berisha – anëtar dhe
Ramadan Gashi – anëtar.*

II. Komisioni vendosi që për Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile të luftës së UÇK-së dhe të familjeve të tyre, në një takim të radhës me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të shikohet mënyra si do të veprohet me procedimin.

4. Shqyrtimi i amendamenteve në Projektligjin për qasje në dokumente publike, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL

Kryetari – I paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet në Projektligjin për qasje në dokumente publike, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. Kërkoj nga anëtarët t'i paraqitnin vërejtjet në amendamente që do të përfshihen në raportin, që do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Ibrahim Makolli - Pati vërejtje në amendamentin 19, sepse ishte në kundërshtim me Ligjin për Gazetën Zyrtare. Pati vërejtje edhe për amendamentin 24 dhe ishte i mendimit se përmbajtja e nenit 19 në Projektligj ishte e qartë.

Lidhur me amendamentin 24 diskutuan edhe Gani Geci, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi dhe Armend Zemaj.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

R E K O M A N D I M

1. Projektligji për qasje në dokumente publike dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me përjashtim të amendamentit 19, që ka të bëjë me nenin 15.1 dhe me amendamentin 24.
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i shqyrtoi propozimamendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe i paraqiti vërejtjet:
 - Amendamenti 19, pjesa e tekstit, që ka të bëjë me publikimin e të gjitha dokumenteve të publikueshme në Gazetën Zyrtare, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (neni 4), ngase ky Ligj parasheh qartë se cilat akte publikohen në Gazetën Zyrtare.
 - Amendamenti 24 është i panevojshëm, sepse përmbajtja e nenit 19 të Projektligjit i përcakton qartë mënyrën e raportimit të secilit autoritet publik dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasjen në dokumentet publike nga njësia përkatëse e Zyrës së Kryeministrit.

5. Të ndryshme

Kryetari - Kërkoj nga Armend Zemaj të angazhohet në procedurën e mbikëqyrjes së Ligjit për faljen, që në afat sa më të shkurtër të caktohet takimi me Zyrën e Presidentit për mbikëqyrjen e këtij Ligji.

Ibrahim Makolli - U pajtua të përsëritet kërkesa drejtuar Zyrës së Presidenti, sepse nuk kemi asnjë përgjigje nga ajo për mbikëqyrjen e Ligjit për faljen. Nëse edhe kësaj radhe nuk i përgjigjet kërkesës së Komisionit, në mbledhjen plenare do ta paraqesë këtë çështje, sepse po i pamundësohet Kuvendit t'i kryejë detyrat e veta.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni